

LIGJ
Nr. 104/2023

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE
TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2020, PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI I PERFORMANCËS DHE INVESTIMEVE NË SEKTORIN E UJËRAVE,
PJESA E DYTË (INFRASTRUKTURA KOMUNALE, FAZA V, PJESA II)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2020, për projektin “Programi i performancës dhe investimeve në sektorin e ujërave, pjesa e dytë (infrastruktura komunale, faza V, pjesa II)”, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.12.2023.

Shpallur me dekreten nr., datë .2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË,
PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR

2020,
“PROGRAMI I PERFORMANCËS DHE INVESTIMEVE NË SEKTORIN E UJËRAVE –
PJESA E DYTË
(INFRASTRUKTURA KOMUNALE FAZA V, PJESA II)”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë;
dhe
qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,
duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,
të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social, ekonomik dhe mjedisor në Republikën e Shqipërisë, *duke in referuar* Protokollit të Bisedimeve Qeveritare të datës 24 nëntor 2020, Kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumat si vijon:

1. për projektin “Programi i performancës dhe investimeve në sektorin e ujërave – pjesa e dytë (infrastruktura komunale faza V, pjesa 11)” një kredi të butë të KfW-së, në vlerë të përgjithshme deri në 50 000 000 euro (me fjalë: pesëdhjetë milionë euro), e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim, nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur dhe nëse situata e riskut, që lidhet me dhënien e kredive Republikës së Shqipërisë, nuk është përkeqësuar;

2. grante për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit në vlerë të përgjithshme deri në 3 000 000 euro (me fjalë: tre milionë euro).

2. Kjo marrëveshje vlen eventalisht edhe për grante shtesë, që vihen në dispozicion me qëllim përgatitjen e projektit të përmendur në nenin 1 apo të masave shoqëruese të nevojshme për të, si edhe në funksion të rritjes së fondeve apo për projekte vijuese të ardhshme, nëse të dyja qeveritë dëshirojnë që mbështetja të vijojë më tej. Premtimet financiare të Republikës Federale të Gjermanisë, për projekte vijuese dhe rritje fondesh për projektet, realizohen përmes njoftimit të qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, që i referohet shprehimisht kësaj marrëveshjeje. Në këto raste vlejnë afatet kohore që i shmangen nenit 2, kreu 2, të cilat do të sillen në vëmendje veçmas në njoftimin e qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e prokurimit përcaktohen në kontratat, që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe granteve, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 do të zhvlerësohet përfundimisht, në rast se kontratat e përmendura në paragrafin 1 nuk lidhen brenda një periudhe pesëvjeçare pas vitit të premtimeve. Për këto shuma afati përfundon me mbarimin e datës 24 nëntor 2025. Në rast se brenda afatit të parashikuar kontratat e përmendura në paragrafin 1 do të jenë lidhur vetëm për një pjesë të premtimeve, atëherë klauzola e zhvlerësimit do të vlejë vetëm për ato shuma të pjesëshme, që nuk mbulohen ende nga këto kontrata.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve, që mund të lindin në bazë të kontratave të huas, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i granteve, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pagesat eventuale për shlyerjen e detyrimeve, që mund të lindin në bazë të kontratave të financimit përmes granteve, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

KfW-ja është e përjashtuar nga taksat direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e projekteve të përmendura në nenin 1, paragrafi 1 apo në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1. Marrëveshja “Për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe evazionit fiskal, në lidhje me taksat mbi të ardhurat dhe kapitalin”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, gjen zbatim në versionin aktual të vlefshëm.

Neni 4

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Regjistrimi i kësaj marrëveshjeje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, realizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pala tjetër kontraktuese njoftohet rreth regjistrimit të kryer përmes përcjelljes së numrit të regjistrimit të Kombeve të Bashkuara, sapo ky numër të jetë konfirmuar prej Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar. Secila prej palëve në marrëveshje mund ta zgjidhë atë, në çdo kohë, me shkrim, në rrugë diplomatike. Zgjidhja e Marrëveshjes bëhet efektive ditën e parë të muajit vijues pas një periudhe dymbëdhjetë mujore duke nisur prej ditës së mbërritjes së notës zyrtare.

4. Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje. Çdo ndryshim i marrëveshjes do të jetë i vlefshëm nëse do të bëhet nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim ndërmjet palëve.

5. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në dakordësi mes palëve kontraktuese, përmes bisedave apo negociatave përkatëse.

Bërë në Tiranë, më 4.10.2023, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË